

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Nr.rregj.them.850(21283-254-51-2015) Nr.Vendimi.800(51-2015-2212)

VENDIM

" Per kthimin e kerkesepadise "

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder ,e përbërë nga:

Ermira Dedja - Gjyqtare

Me sekretare seance Arjeta Plaku,sot me date 25.5.2015, mori ne shqyrtim ne seance pergatitore, çeshtjen civile me nr.rregj.them 850(254),date 31.1.2015, qe I perket:

Paditese: SH.A "Parku i Udhetareve Shkoder",perfaqesuar nga administrator Petrit Sefo, perfaqesuar me deklarim ne seance nga av.Miranda Ramadani, me Nr.license 5255, anetare e Dhomes se Avokatise Shkoder.

E paditur: Bashkia Shkoder, e perfaqesuar me autorizim me nr.2160 prot,date 16.4.2015 nga juriste Eva Baja

Person i trete: 1.Shoqeria e Siguracioneve "Albsig",dega Shkoder ,prane radio Shkodres, e perfaqesuar me autorizim me nr.366 prot,date 23.3.2015 nga Rozana Marleci.

2.Firma "Dede Vukaj"shpk Shkoder Hot i Ri, e perfaqesuar me prokure te posaçme me nr. 542,nr.kol.401,date 27.2.2015 nga av.Besmir Kolçe,me nr.license4346,Nr.Nipti L16306006T,,anetar i Dhomes se Avokatise Shkoder.Ne mungese.

3.Firma Kappa oil ,Durres,Dega Shkoder ,Kryqezim Rus, e perfaqesuar me autorizim me date 20.4.2015 nga Ibrahim Dibra.Ne mungese

4.Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave ,Shkoder, e perfaqesuar me autorizim me nr.3972 prot ,date 22.4.2015 nga Sirjana Bakushi

Objekt: 1.Detyrim i pales se paditur Bashkia Shkoder te permbushe detyrimet e prapambetura ndaj sh.a 'Parku i Udhetareve Shkoder',ne

zbatim te vendimit te Keshillit Bashkiak nr.107, date 30.11.2007 si dhe te Bilancit financiar per vitin 2013, te miratuar nga Kryetari i bashkise Shkoder ne vleren totale 12 760 621 leke, si detyrim qe "P.U.SH" sh ka ndaj Drejtorise Rajonale te Tatim taksave Shkoder, kryesisht sigurimet shoqerore te punonjesve ne masen 9 736 907 leke, Firmes "Dede Vukaj" shpk-Shkoder, per blerje karburanti ne masen 1 168 816 Firmes "Kappa Oil "Durrës ,per lubrifikante ne vleren 468 198 leke dhe Shoqerise se Siguracioneve "Albsig", dega Shkoder ,per siguracionin e mjeteve te transportit ne vleren 1 368 700 leke, detyrime te cilat duhet te permbushen nga debitori Bashkia Shkoder gjate procedurave te likuidimit te shoqerise aksionere sh.a "Parku i Udhetaresve "Shkoder.

2. Detyrimin e pales se paditur Bashkia Shkoder te permbushet detyrimin per pagesen e grupt te punes deri ne perfundim te procedurave se likuidimit te shoqerise , bazuar ne ne V.K.B nr.58, date 29.6.2012" per ngritjen e stuktures qe do te merret me administrimin e shoqerise se P.U.SH", strukture e cila administron dhe realizon procesin e likuidimit te sh.a "P.U.SH" i perbere nga pese anetare , pagese e cila eshte nderprere nga data 1.8.2014 e ne vazhdim. Konkretisht pagesa ne muaj per secilin anetare eshte likuidatori pagen prej 71 187 leke ekonomiste/financiere pagen prej 59 517 leke, magazinieri /roje turni 1 pagen prej 35 010 leke, dy roje me pagen secili prej 26 008 leke.

Shpenzimet gjyqesor ne ngarkim te pales se paditur Bashkia Shkoder

Baza Ligjore: Neni 32/a, 102, 106, 128-130, 154-156, 334/e, 335e vijues i K.Pr.Civile; nenet 445 e vijues i K.Civil te R.SH. Ligi nr.9723 date 3.5.2007" per QKR", ligji nr.9901, date 14.4.2008" Per shoqerite tregtare", nenet 135, 145, 187/b, 191, 196 etj. Ligji nr.10340, date 28.10.2010 "per pagesen e detyrimeve ndaj te treteve te ndermarrjeve dhe sh.a-ve ne pronesi te pushtetit vendore".

VËREN

Pala paditese SH.A "Parku i Udhetaresve Shkoder" i eshte drejtuar gjykates me kerkesepadi me objektin e sipercituar.

Në seancen e veprimeve perгатitore te dates 25.5.2015 ora 13:30 u paraqiten pala paditese e perfaqesuar nga administrator Petrit Stefo dhe av.Miranda Ramadani, pala e paditur Bashkia Shkoder ,e perfaqesuar nga juriste Eva Baja ,personat e trete Shoqeria e Siguracioneve "Albsig", dega Shkoder e perfaqesuar nga

Rozana Marleci, dhe Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, Shkoder, e perfaqesuar nga juriste Sirjana Bakushi, ndersa nuk u paraqiten personat e trete Firma "Dede Vukaj" shpk Shkoder Hot i Ri dhe Firma Kappa oil, Durres, Dega Shkoder.

Nga ana e kesaj gjykate ne seance e veprimeve pergatitore te dates 14.5.2015, iu la kohe pales paditese te plotesoje te meten e kerkesepadise ne lidhje me provat shkresore persa i perket legjitimitit te saj si pale paditese ne kete proces gjyqesore. Ne seancen ne vijim, date 25.5.2015, nga pala paditese nuk u paraqiten provat shkresore, megjithe korrespondencen e realizuar gjate kesaj periudhe, nga ana e saj me Institucionet perkatese (permes shkresave te cituara shih porcesverbalin) per tu pajisur me dokumentin qe legjitimon palen ne kete proces.

Duke e konsideruar kete fakt si nje e mete procedurale, Gjykata ne respekt te detyrimeve qe buron nga nenin 154/a i K.Pr.Civile i la nje afat te arsyeshem, pales paditese, per plotesimin e kesaj te mete, paraqitjen e provave shkresore. Ne seancen e dates 25.5.2015, Gjykata konstaton se, nuk eshte plotesuar e meta e padise e evidentuar prej Gjykatës ne kete moment te hetimit gjyqesore.

Për sa sipër, Gjykata çmon të disponojë në përputhje me kërkesat e ligjit procedural civil, nenit 154/a të K.Pr.Civile që, kerkesepadia se bashku me aktet, ti kthehet pales paditese si kerkesepadi me të meta.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 154, 154/a të K.Pr.Civile;

VENDOS

1. Kthimin e kerkese padise se bashku me aktet, pales paditese Sh.a Parku I Udhetareve Shkoder.
2. Kunder ketij vendimi mund te behet ankimi i vecante ne Gjykatën e Apelit, Shkoder, brenda 5 diteve nga e nesermja e shpalljes se vendimit. Per palet ne mungese, ky afat fillon nga dita e marrjes dijeni te vendimit.

U shpall ne Shkoder, date 25.5.2015

Sekretare

Arjeta Plaku

Gjyqtare


Ermira Dedja



KA MARRE FORME
E DT. 27.07.2015

VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRE FORME TE PRERE
SOT ME DT. 27.07.2015

KRYESEKRETAR
MIRSAD ISUFI



KANCELAR
ARTAN DRAGONI

